



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.415/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me Anita Nikçi-Morina dhe zyrtarja ligjore Ilirjana Makolli në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N. (Z) O. nga P. me vendbanim në Rr. “...” të cilën e përfaqëson sipas autorizimit vëllai i tij H. O. nga P., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë/Departamenti i Administratës Pensionale, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore - Ministria e Drejtësisë, baza juridike, njohja e të drejtës për Pensionin për Persona me Aftësi të Kufizuara, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të paditëses dhe të autorizuarit të saj dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me dt.04.09.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N. (Z) O. për njohjen e të drejtës në pensionit për Persona me Aftësi të Kufizuara nga për derisa të mos vërtetohet se aftësia e kufizuar e tij ka ndryshuar, në vlerën e caktuar për këtë lloj pensioni, ndërsa anulohet aktvendimi i të paditurës, MPMS/DAP në Prishtinë, me nr.5000483 i datës 22.02.2016.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

E paditura, MPMS/DAP me aktvendimin me nr. Dosje 5000483 i datës, 22.02.2016 duke vendosur në rivendosje, sipas vërejtjeve të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka refuzuar ankesën e ankueses, në rastin aktual të paditëses, dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallë se parë si plotësisht të pabazuar.

Në shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike sipas nenit 41 të Ligjit për Konflikte Administrative (LKA), në prezencë të paditësit të cilën e përfaqëson sipas autorizimit, vëllai i tij, H. O., në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, të thirrur në mënyrë të rregullt nga gjykata.

Në shqyrtimin kryesor paditësi përmes përfaqësuesit ri-konfirmon pretendimet e tij të cekura në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se në bazë të provave, dëshmimeve dhe ekspertizës së fundit në mënyrë bindëse është konstatuar se paditësi është i paaftë për punë dhe i plotëson të gjitha kushtet ligjore që të gëzojë të drejtën e pensionit të plotë si pasojë e paaftësisë së përhershme. Paditësi i kërkon gjykatës që në tërësi ta aprovonjë si të bazuar padinë e paditësit dhe ti njihet e drejta në pension të kategorive që përcakton ligji mbi personat me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi me dt.12.07.2016 ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se Komisionet Mjekësore kanë vlerësuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret për njohjen të drejtës në këtë pension dhe se paditësi nuk i ka ofruar dëshmi të mjaftueshme Komisioneve mjekësore të MPMS/DAP për të dëshmuar të drejtën në këtë pension.

Gjykata në seancën përgatitore, me qëllim të vendosjes së çështjes në meritum, ex-officio ka marr aktvendim për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga institucioni i Qendrës Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.26.07.2017 ka bërë administrimin e provave dhe atë: përgjigja në padi e dt.12.07.2016, aktvendimi i MPMS-DAP me nr. të dosjes nr.5000483 i datës, 22.02.2016, vendimi për pensionin e personave me aftësi të kufizuar i dt. 12.01.2009 12.07.2014, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.690/2014 i dt. 07.12.2015 , raporti i qendrës spitalore me nr.10.03.2016 dosja e vlerësimit të komisionit mjekësor për paditësen, ekspertiza e dhënë nga QKUK për paditësen e dt. 02.06.2017

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe është vërtetuar se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Gjykata gjen se vendimi i kontestuar i MMPS/DAP përmban të meta të tilla, për shkak të cilave, nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative respektivisht të nenit 84 par. 2 i cili parasheh që akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë, përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, të bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata dhe një deklaram të bazës ligjore në të cilin bazohet akti. Për më tepër, sipas Ligjit për Procedurë Administrative çdo akt administrativ duhet të jetë mirë i arsyetuar pasi neni 85 i Ligjit për Procedurë Administrative përcakton se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Gjykata gjen që vendimet e të paditurës të dt.22.02.2016 janë juridikisht të paqarta dhe kundërthënëse me vetveten dhe me arsyetimin e tyre. Në arsyetimet e tyre nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimeve të kundërshtuara. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “duke vepruar sipas vërejtjeve të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.690/2014 i dt. 07.12.2015 sipas ankesës së ankueses, komisioni mjekësor në seancën e dt.26.04.2014 ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësorë, aktvendimin e komisionit mjekësorë të shkallës së parë dt.11.02.2014 në përputhje me nenin 2.2 të ligjit, 2003/23 për pensionin për persona me aftësi të kufizuara dhe ka konstatuar se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të dëshmuar se të e njëjta ekziston 90 % paaftësia e andaj nga këto arsye refuzuar ankesa si e pabazuar”, sepse ankuesja nuk i plotësohen kriteret në përputhje me nenin 3 të Ligjit 2003/23 për PPAK.

Pra është e rëndësishme që autoritetet publike, në këtë rast MMPS, të jap arsyetime bindëse dhe të ndërtuara mire ligjërisht për vendimin e marre në çdo rast individual i cili duhet të përfshijë edhe kriteret ligjore edhe elementet faktike në mbështetje të vendimit.

Gjykata, duke vlerësuar ligjshmërinë aktit kontestues të nxjerrë në rivendosje, nga organi i paditur sipas vërejtjeve të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.690/2014 i dt. 07.12.2015 **gjen** se paditëses i është refuzuar serish kërkesa respektivisht ankesa e saj për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuara, vetëm me konstatimin se, refuzimi i kërkesës është “bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës dhe ka konstatuar se tek i njëjta aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston.”

Kjo gjykatë pa administrimi i provave të përmendura më sipër sjell - fale besimin raporteve mjekësore të paditëses, të dt.02.06.2017 me të cilin paditëses i është njohur kjo e drejtë në Pensionin për Persona me aftësi të Kufizuara, e në veçanti ekspertizës të se siguruar nga QKUK për paditësen me dt.25.04.2016 në përbërje prej tre (3) profesionisteve të fushave përkatëse të caktuar për këtë ekspertizë e që janë: Dr. Burim Tahiri dhe Fatmir Ramxhiku -Neurolog dhe Samire Braina –Psikiatër të cilët pasi kanë ekzaminuar pacientin kanë nxjerr këtë konkluzion/përfundim; se vuan nga Sindroma psikoorganike kronike /Retardim psikomotor i shkalles se lehte , ku vërtetohet shkalla e paaftësisë për pune është 90 %

Andaj nga administrimi i provave të përmendura më sipër, në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata vërtetoi se paditësi në këtë rast – N. O., është person me aftësi të kufizuara dhe në përputhje të nenit 2.2 të ligjit 2003/23, respektivisht nenit 3 të tij i plotëson kriteret për të qenë shfrytëzuese e pensionit për persona me aftësi të kufizuara. Nga provat e administruara u vërtetua se paditësi ka dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte andaj Gjykata e aprovon kërkesëpadinë saj si të bazuar dhe obligon të paditurën (MMPS/DAP) që të bëjë kompensimin mjeteve paditëses për pensionin si në pikën dy (II) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj pretendimet tjera të paditurës të dhëna në përgjigje në padi mirëpo si të tilla nuk i aprovoj si të bazuara pasi nuk kanë ndikim në procesin e vendimmarrjes, andaj Gjykata u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. nr.415/2016 dt. 04.09.2017

Zyrtarja ligjore

GJYQTARJA

Ilirjana Makolli

Anita Nikçi-Morina

Këshillë Juridike:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita të marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.